



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1744/2 prot.

Elbasan, me 19.08.2025

VENDIM

Nr. 56, datë 19.08.2025

Për disa ndryshime në VBA nr 59 datë 31.12.2024
"Për ulje tarife vjetore të shkollimit të studentëve në Ciklin e dytë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2024-2025".

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së Nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, VBA nr 51 datë 28.10.2024 "Për miratimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesave të studentëve "Për ulje tarife vjetore shkollimi në vitin akademik 2024-2025, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi të Ciklit të dytë të studimeve - Master", VBA nr. 59, datë 31.12.2024 "Për ulje tarife vjetore të shkollimit të studentëve në Ciklin e dytë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2024-2025", Relacionit të Administratorit datë 18.08.2025 "Për disa ndryshime në VBA nr 59 datë 31.12.2024 "Për ulje tarife vjetore të shkollimit të studentëve në Ciklin e dytë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2024-2025"", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

- 1- Përfitojnë ulje tarife shkollimi 64 studentë me rezultate (mesatare 9-10-të) brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur. (shtohet studenti Indrit Gezim Jaupaj)
- 2- Përfitojnë ulje tarife shkollimi 143 studentë me kriteret e tjera mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur. (shtohet studenti Rakela Bujar Çala, hiqet studenti Rabiye Ardian Kasa)
- 3- Nuk përfitojnë ulje tarife shkollimi 44 studentë, nga të cilët 15 studentë me mesatare me program të dytë studimi dhe 29 studentë për arsye të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara, sipas listës bashkëlidhur. (shtohet studenti Rabiye Ardian Kasa, hiqet Rakela Bujar Çala)
- 4- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
Dr. Ardian Durrmishi

